



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

## RAPORT ME REKOMANDIME

### I

## MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS PËR VIZITËN NË QENDRËN KORREKTUESE PËR FEMRA DHE TË MITUR NË LIPJAN

**Për:**

- Z. Abelard Tahiri, Ministër**  
Ministria e Drejtësisë
  
- Z. Uran Ismaili, Ministër**  
Ministria e Shëndetësisë
  
- Z. Milazim Gjocaj, Drejtor**  
Departamenti i Shëndetësisë në Burgje
  
- Z. Nehat Thaqi, Drejtor i Përgjithshëm**  
Shërbimi Korrektues i Kosovës
  
- Z. Hestet Loku, Drejtor**  
Qendra Korrektuese në Lipjan

**Prishtinë, 24 maj 2019**

## HYRJE

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit, më 23 dhe më 24 janar 2019, e ka vizituar Qendrën Korrektuese për Femra dhe të Mitur në Lipjan.

MKPT-ja, bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund t'i vizitojë, në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë stacionet policore, qendrat e paraburgimit, burgjet, vendet ku mbahen të huajt e privuar nga liria, si dhe institucionet psikiatrike dhe të kujdesit social.

Bazuar në këtë mandat, MKPT-ja, më 23 dhe më 24 janar 2019, e vizitoi Qendrën Korrektuese Edukuese për Femra dhe të Mitur në Lipjan (në tekstin e mëtejme *QKFM*). Po ashtu, MKPT-ja ka realizuar vizita *ad-hoc* në QKFM gjatë këtij viti.

QKFM-ja në Lipjan është institucion i tipit gjysmë të hapur, i vetmi në Republikën e Kosovës, ku janë të vendosur disa kategori të burgosurish si: të miturit me masë edukative, të miturit e dënuar, të miturit e paraburgosur, femrat e dënuara, femrat e paraburgosura dhe femrat e mitura. Gjatë vizitës, MKPT-ja u njoftua nga Drejtoria e Qendrës Korrektuese në Lipjan se kapaciteti i QKFM-së është për 138 persona, ndërsa gjatë vizitës nga MKPT-ja, aty ishin të vendosur gjithsej 77 të burgosur të të gjitha kategorive.

### Objektivi i vizitës

Qëllimi i kësaj vizite ishte monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të MKPT-së, të cilat u ishin dërguar autoriteteve kompetente përmes Raportit me rekomandime, i publikuar më 20 dhjetor 2016.<sup>1</sup>

Përveç kësaj, gjatë vizitës u trajtua çështja e procedurave të pranimit të femrave madhore dhe të miturve, njoftimi me të drejtat e tyre, trajtimi, kushtet e akomodimit, regjimi, kujdesi shëndetësor, incidentet ndërmjet të burgosurve, aktivitetet në dispozicion, kontaktet me botën e jashtme, procedurat e parashtrimit të ankesave dhe masat disiplinore, të cilat mund t'u shqiptohen sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe Kodit nr. 03/L-193 të Drejtësisë për të Mitur.

### Përbërja e grupit monitorues

1. Grupi monitorues përbëhej nga udhëheqësja e MKPT-së, dy këshilltarë ligjorë për parandalim të torturës, një psikologe-këshilltare, një mjekë-këshilltare, një këshilltar-punëtor social, dy ekspertë të Këshillit të Evropës (në cilësi të vëzhguesve).

### Bashkëpunimi i QKFM-së me MKPT-në gjatë vizitës

2. Gjatë vizitës nga MKPT-ja të QKFM-së në Lipjan, personeli i shërbimit korrektues dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi, pa vonesa, pati qasje të papenguar në të gjitha vendet e vizituara. Ekipit iu

<sup>1</sup> Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën Korrektuese për Femra dhe të Mitur në Lipjan, publikuar më 20 dhjetor 2016, në: <https://www.oik-rks.org/2016/12/21/raporti-i-mkpt-te-iap-nga-vizita-qendres-korrektuese-ne-lipjan-2/>.



siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën dhe iu mundësuan intervistat me personat e dënuar dhe me të paraburgosur, pa prezencë të zyrtarëve korrektues dhe pa prezencë të personelit shëndetësor. MKPT-ja, gjatë viteve 2017 dhe 2018, ka kryer disa vizita *ad-hoc* në QKFM.

### **Keqtrajtimi**

3. MKPT, gjatë vizitave në QKFM, intervistoi një numër të konsiderueshëm të të miturve të dënuar dhe të paraburgosur, të femrave të dënuara dhe të paraburgosura. MKPT-ja nuk mori asnjë ankesë për keqtrajtimit fizik dhe për përdorim të tepruar të forcës fizike të shkaktuara nga zyrtarët korrektues. Për dallim nga situata e konstatuar në Raportin me rekomandime, i publikuar në vitin 2016, MKPT-ja vërejti se ekziston një klimë pozitive e marrëdhënieve dhe komunikim i mirë interaktiv ndërmjet të miturve dhe zyrtarëve korrektues.

### **Kushtet materiale**

#### **Kushtet materiale në pavijonet ku akomodohen të miturit**

4. MKPT-ja, si edhe gjatë vizitës në vitin 2016, sërish vërejti se janë të nevojshme renovimet në hapësirat ku akomodohen të miturit e gjinisë mashkullore. MKPT-ja mori ankesa nga të miturit se gjatë natës është ftohtë, që vjen si pasojë e gjendjes teknike të dritareve. Po ashtu, MKPT-ja vërejti se tualetet janë të dëmtuara, në disa qeli ka lagështi dhe kushtet higjienike nuk janë në nivel të duhur. MKPT nuk vërejti mbipopullim në pavijonet ku akomodohen të miturit e dënuar dhe ata të paraburgosur.
5. Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale shprehimisht përcakton se i dënuari ka të drejtë për strehim, i cili u përgjigjet kushteve bashkëkohore higjienike dhe rrethanave vendore klimatike.<sup>2</sup> Për më shumë, ky ligj përcakton se lokalet nuk duhet të kenë lagështi dhe duhet të kenë pajisje sanitare adekuate dhe mjete të tjera të nevojshme për higjienë personale.<sup>3</sup>
6. MKPT-ja vërejti se shtretërit e të miturve nuk kanë çarçafë; dyshekët janë jocilësorë, si dhe batanijet janë shumë të vjetruara. Neni 38, paragrafi 3, i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale shprehimisht përcakton: "*Personit të dënuar i sigurohet shtrat i veçantë dhe shtresa e mbulesa të mjaftueshme të cilat duhet të jenë të pastra kur i jepen, duhet të mirëmbahen si duhet dhe të ndërrohen rregullisht.*" Qelitë ku qëndronin të miturit, sa i përket madhësisë dhe ndriçimit natyral, janë në pajtim me standardet e përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejshëm *KPT*)<sup>4</sup> dhe me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.
7. Rregullat Evropiane të Burgjeve, të miratuara nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës, më 11 janar 2006, sa i përket akomodimit të personave të dënuar, përcaktojnë se akomodimi i cili u sigurohet të burgosurve, veçanërisht lokalet për të fjetur, duhet të jenë të tilla që ta respektojnë dinjitetin e njeriut dhe, për aq sa është e mundur, ta respektojnë privatësinë dhe t'i plotësojë kërkesat shëndetësore dhe higjienike, t'i kushtohet vëmendje e

<sup>2</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 1.

<sup>3</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 3.

<sup>4</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Hapësira e Banimit për një të Burgosur, shih:

<https://rm.coe.int/16806cc449>.

duhur kushteve klimatike, e veçanërisht hapësirës (metrave katrorë), ndriçimit, ngrohjes dhe ventilimit.<sup>5</sup>

8. Më tej, Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, më 14 dhjetor 1990, në pikën D, paragrafi 31, shprehimisht përcaktojnë: *“Të miturit e privuar nga liria kanë të drejtë të vendosen në objekte dhe të kenë shërbime, të cilat i plotësojnë të gjitha kriteret shëndetësore dhe të ruajtjes së dinjitetit të njeriut.”*
9. Po ashtu, Rregulli 13 i Rregullave të Mandelës, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, në vitin 2015, përcakton si në vijim: *“Të gjitha hapësirat e përcaktuara për përdorim nga të burgosurit dhe në veçanti hapësirat e fjetjes duhet të plotësojnë të gjitha kriteret shëndetësore, vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet kushteve klimatike, madhësisë minimale të hapësirës së banimit, ndriçimit, ngrohjes dhe ventilimit.”*<sup>6</sup> Prandaj, MKPT-ja konsideron se autoritet kompetente duhet të ndërmarrin masa për ta evituar këtë situatë, në pajtim me standardet e lartpërmendura nacionale dhe ndërkombëtare.

#### **Kushtet materiale në pavijonet ku akomodohen femrat**

10. Kushtet e akomodimit në këto pavijone në përgjithësi janë të mira dhe në pajtim me standardet nacionale dhe ndërkombëtare. MKPT-ja nuk vërejti mbipopullim në pavijonet ku mbahen femrat e dënuara dhe të paraburgosura. Qelitë kanë ndriçim të mjaftueshëm, madhësia e qelive është në pajtim me standardet e KPT-së dhe me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.
11. Po ashtu, MKPT-ja, gjatë monitorimit të QKFM-së, vizitoi edhe Shtëpinë e Nënave, në të cilën akomodohen femra shtatzëna të dënuara dhe ato që kanë fëmijë. Kushtet në këtë shtëpi janë të mira dhe i plotësojnë kushtet për mbajtjen dhe rritjen e fëmijës deri në moshën e përcaktuar me standardet ndërkombëtare.<sup>7,8</sup> Sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, femra ka të drejtë ta mbajë fëmijën e saj deri në moshën tetëmbëdhjetë muajsh.<sup>9</sup> Sipas Drejtorisë, e burgosura e fundit e cila ishte e vendosur në Shtëpinë e Nënave, ishte përfaqësues për një viti e gjysmë.

#### **Ushqimi**

12. Sa u përket personave të dënuar, Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton të drejtën për ushqim të përshtatshëm për ruajtjen e mirë të shëndetit dhe fuqisë së tij me tri shujta për çdo ditë, të cilat duhet të jenë të llojllojshme dhe ushqyese. Ushqimi që i jepet personit të dënuar duhet t’i përshtatet moshës dhe gjendjes së tij shëndetësore, natyrës së

<sup>5</sup> Rekomandimi Rec (2006) 2 i Komitetit të Ministrave për Shtetet Anëtare për Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rregulli 18.1. Për më shumë, shih në: <https://rm.coe.int/european-prison-rules-978-92-871-5982-3/16806ab9ae>.

<sup>6</sup> Rregullat e Mandelës, shih në: [https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E\\_ebook.pdf](https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf).

<sup>7</sup> Rregullat e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (Rregullat e Bankokut) për Trajtim të Femrave të Burgosura, Rregulli 3. Për më shumë shih në: [https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Bangkok\\_Rules\\_ENG\\_22032015.pdf](https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/Bangkok_Rules_ENG_22032015.pdf).

<sup>8</sup> Standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës për Gratë në Burgje, publikuar në janar të vitit 2018. Shih në: <https://rm.coe.int/168077ff14>.

<sup>9</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 53, par. 1.



punës, stinës e kushteve klimatike dhe, aq sa është e mundur, kërkesave të tij fetare dhe kulturore.<sup>10</sup>

13. Më tej, Ligji përcakton se personi i dënuar i cili kryen punë të rënda, personi i sëmurë, gruaja shtatzënë, ose ajo e cila ka lindur fëmijë, kanë të drejtë për ushqim të caktuar nga mjeku.<sup>11</sup> Mjeku, ose eksperti tjetër për ushqim, e kontrollon ushqimin dhe, para shërbimit të çdo shujte, e njofton drejtorin e institucionit korrektues për cilësinë e ushqimit dhe konstatimet e tij shënohen në librin përkatës.<sup>12</sup>
14. MKPT-ja vërejtë se kushtet higjienike në kuzhinë ishin në nivelin e duhur. Staf i kuzhinës dhe të burgosurit e angazhuar në punë janë të pajisur me librezë sanitare. MKPT-ja nuk mori ankesa nga të burgosurit sa i përket sasisë dhe kualitetit të ushqimit, i cili u shërbehet.

### Regjimi

15. Në QKFM-në në Lipjan funksionon shkolla e mesme e ultë dhe shkolla e mesme e lartë në kuadër të sistemit publik të arsimit. Në kohën kur MKPT-ja e vizitoi QKFM-në, shkolla nuk ishte funksionale, për shkak të grevës në shkollat publike.
16. E drejta e të burgosurit për arsimim përcaktohet me nenet 83, 84 dhe 85 të Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale. Neni 83 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale shprehimisht përcakton: *“Personi i dënuar ka të drejtë në shkollim fillor dhe të mesëm, në pajtim me ligjin për arsimin fillor dhe të mesëm.”* Më tej, neni 2 i Ligjit përcakton se përgjegjës për caktimin e lokacionit dhe infrastrukturës ku do të zhvillohet mësimi është Shërbimi Korrektues i Kosovës.
17. Ndërsa neni 84 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton se, përmes programeve të veçanta, drejtori i institucionit korrektues ia mundëson personit të dënuar vijimin e shkollimit fillor, të mesëm, universitar, apo ndonjë shkollim tjetër. Shpenzimet e shkollimit të tillë mbulohen nga personi i dënuar.
18. Po ashtu, neni 119 i Kodit të Drejtësisë për të Mitur përcakton: *“Nëse nuk ka orë mësimore për lëndë të caktuara ose nuk ka nivel arsimor në institucionin edukativ korrektues, i mituri lejohet të vijojë mësimin jashtë institucionit edukativo korrektues, nëse vijimi i tillë i mësimit nuk është i dëmshëm për ekzekutimin e masës edukative dhe vendimi arsyetohet me përparimet e mëparshme të të miturit në shkollim.”*
19. Standardet e KPT-së<sup>13</sup> përcaktojnë se të miturve të privuar nga liria duhet t’u ofrohet një program i plotë arsimimi, sporti, trajnimi profesional, rekreacioni dhe aktivitete të tjera. Edukimi fizik duhet të përbëjë një pjesë të rëndësishme të atij programi.
20. Neni 139 i Kodit të Drejtësisë për të Mitur përcakton se i mituri ka të drejtë t’i kalojë të paktën tri orë në ditë në ambient të hapur brenda institucionit. MKPT-ja vërejtë se të miturve u garantohen tri orë shëtitje në ajër të pastër. Po ashtu, në dispozicion të të miturve janë edhe aktivitetet sportive, programi EQUIP dhe angazhimi në punë, i cili gjatë stinës së verës është

<sup>10</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39, par. 1.

<sup>11</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39, par. 2.

<sup>12</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39, par. 3.

<sup>13</sup> Pjesë nga Raporti i 9-të i Përgjithshëm [CPT/Inf (99) 12 ], kapitulli VI. Të miturit në heqje lirie, paragrafi 31.

më i madh, pasi që QKFM-ja posedon edhe një serrë, në të cilën mund të angazhohen në punë të burgosurit. Sipas Drejtorisë, tash për tash ofrohen trajnime profesionale për hidroinstalues, për elektroinstalues dhe për ndërtimtari.

21. Nga të dënuarat femra, MKPT-ja u njoftua se atyre u mundësohet shëtitja jashtë qelisë dy herë në ditë nga një orë, gjë që është në pajtim me nenin 37 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.
22. MKPT-ja vërejt se femrat e dënuara janë të angazhuara me punë në kuzhinë dhe në pastrim. Sa i përket vijimit të kurseve, siç janë rrobaqepësia dhe floktaria, tash për tash nuk ka femra të angazhuara. Po ashtu, MKPT-ja, gjatë vizitës u njoftua nga të dënuarat femra se gjatë javës ndjekin ritet fetare, të cilat predikohen nga zyrtarja kompetente e Bashkësisë Islame të Kosovës, e cila vjen rregullisht në QKFM.
23. Të paraburgosurit angazhohen në punë të caktuara, për të cilat nuk nevojitet leje nga gjykata kompetente. MKPT-ja sërish inkurajon autoritetet që t'i shtojnë angazhimet jashtë qelisë edhe për personat e paraburgosur, për aq sa kjo është e mundur. MKPT-ja konsideron se, sa më e gjatë të jetë kohëzgjatja e paraburgimit, aq më i pasur duhet të jetë edhe regjimi i cili u ofrohet. Në kuadër të QKFM-së funksionon edhe biblioteka, e cila është mjaft e pajisur me libra dhe romane të ndryshme.
24. MKPT-ja vërejt se në dispozicion të të miturve kishte programe të ndryshme psiko-sociale, të organizuara nga organizatat joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare. Në mesin e tyre janë edhe art terapia dhe teatër terapia, si dhe ekspozita e organizuar, ku janë prezantuar punimet e të miturve nga arti figurativ.

### **Kujdesi shëndetësor**

25. Neni 43 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton se i dënuari ka të drejtë për shërbime shëndetësore pa pagesë. Personi i dënuar, të cilit nuk mund t'i ofrohet trajtim i duhur mjekësor në institucionin korrektues, dërgohet në spitalin e burgut, në institucionin psikiatrik adekuat, ose në ndonjë institucion tjetër, për përkujdesje shëndetësore.<sup>14</sup>
26. Personeli mjekësor në Qendrën Korrektuese në Lipjan përbëhet prej 5 mjekëve të përgjithshëm të rregullt dhe 11 infermiereve. Prej tyre, përveç mjekëve të përgjithshëm, njësia shëndetësore ka edhe një stomatolog të rregullt, një radiolog të rregullt, dy psikiatër dhe dy psikologë. Mjekët e përgjithshëm punojnë prej orës 08:00 deri në orën 16:00. Shërbime shëndetësore të burgosurve mund t'u jepen edhe në institucionet publike shëndetësore, sipas nevojës dhe rekomandimit të mjekut kompetent. MKPT-ja konstaton se niveli i shërbimeve mjekësore të ofruara në QKFM mbetet në nivel të kënaqshëm.

### **Rëndësia e kontrolleve mjekësore të të burgosurve të sapo pranuar**

27. KPT-ja vazhdimisht thekson rëndësinë e ekzaminimit mjekësor të të burgosurve të sapo pranuar, veçanërisht në institucionet, të cilat përbëjnë pikë hyrje në sistemin e burgjeve. Një ekzaminim i tillë është esencial, veçanërisht për të parandaluar vetëvrasjet dhe përhapjen e sëmundjeve transmetuese (siç janë tuberkulozi, hepatiti B/C, HIV).

<sup>14</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 43, paragrafi 2.



28. Sipas KPT-së, shërbimet mjekësore të burgut po ashtu mund të japin kontribut të rëndësishëm në parandalimin e keqtrajtimit fizik, gjatë periudhës menjëherë para burgosjes, domethënë në periudhën kur personat janë në mbajtje nga agjencitë e zbatimit të ligjit, përmes regjistrimit sistematik dhe me kohë të lëndimeve dhe kur kjo është e përshtatshme, përmes sigurimit të informatave për autoritetet relevante.<sup>15</sup>
29. Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe Praktika Standarde e Veprimit<sup>16</sup> përcaktojnë obligimin e autoriteteve që i burgosuri i sapo pranuar t'i nënshtrohet kontrollit mjekësor brenda 24 orëve nga momenti i pranimit.<sup>17</sup>
30. Obligime të tilla përcaktohen edhe me aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve, siç janë: Rregullat e Mandelës<sup>18</sup>, Rregullat Evropiane të Burgjeve<sup>19</sup> dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.<sup>20</sup>
31. QKFM-ja e njoftoi ekipin e MKPT-së se të sapo pranuarit kontrollohen brenda afatit prej 24 orësh nga momenti i arritjes në këtë qendër. Këto nënkuptojnë një kontroll të përgjithshëm sipas Praktikave Standarde të Veprimit (PSV) të Departamentit Shëndetësor të Burgjeve. Ky pohim u vërtetua nga ekipi monitorues përmes kontrollit të dosjeve mjekësore dhe intervistave me të burgosurit.
32. Gjatë vizitës, MKPT-ja intervistoi të miturin L.L. Rasti në fjalë është hapur për hetime të mëtejme në Institucionin e Avokatit të Popullit, më 8 janar 2019, bazuar në ankesën e prindërve të të miturit, për mostrajtim të duhur shëndetësor. Lidhur me këtë, Avokati i Popullit, pas vizitës së të miturit në fjalë nga MKPT-ja dhe analizimit të gjendjes shëndetësore, më 15 janar 2019, i rekomandoi DShB-së që i mituri menjëherë të futet nën observim të përhershëm, deri në një vendim tjetër të autoriteteve shëndetësore.
33. Gjatë kësaj vizite, i mituri u intervistua edhe nga psikiatri - ekspert i Këshillit të Evropës. Bazuar në intervistën me të miturin dhe dokumentacionin e shqyrtuar mjekësor, MKPT-ja rekomandoi dërgimin sa më të shpejtë të të miturit në institucion përkatës shëndetësor, jashtë QKFM-së.
34. Më 11 shkurt 2019 Drejtoria e QKFM-së, përmes postës elektronike zyrtare, e njoftoi MKPT-së se i mituri në fjalë, sipas urdhrit të gjykatës, u dërgua për trajtim të mëtejme në Institutin e Psikiatrisë Forenzike. MKPT-ja, përmes këtij Raporti, përshëndet angazhimin serioz të

<sup>15</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 26-të i Përgjithshëm, paragrafi 72, në: <https://rm.coe.int/168070d0c8>.

<sup>16</sup> Praktika Standarde e Veprimit e Departamentit të Shëndetësisë në Burgje (DShB), e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë. Për më shumë shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>.

<sup>17</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 31.

<sup>18</sup> Rregullat e Mandelës, Rregulli 34. Shih në: [https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E\\_ebook.pdf](https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf).

<sup>19</sup> Këshilli i Evropës, Rekomandimi (2006) 2 i Këshillit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve, pika 42.1. Shih në:

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804c221d>.

<sup>20</sup> Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, pika 27, në: [https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45\\_113.pdf](https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45_113.pdf).

Drejtorisë së QKFM-së dhe të DShB-së për ta menaxhuar me seriozitet dhe profesionalizëm rastin në fjalë, si dhe zbatimin e rekomandimit të MKPT-së.

### **Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore**

35. Sa i përket konfidencialitetit të shërbimeve mjekësore, MKPT-ja, bazuar në intervistat e zhvilluara me të miturit, si dhe me personelin shëndetësor, konstaton se këto shërbime jepen nën kushte të cilat respektojnë konfidencialitetin, respektivisht jepen pa prezencë të zyrtarëve korrektues, përveç në raste kur prezenca e tyre kërkohet nga mjeku dhe në dosjen mjekësore të të burgosurit ka qasje vetëm personeli shëndetësor.
36. Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore parashihet me Praktikën Standarde të Veprimit,<sup>21</sup> të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale<sup>22</sup>, me standardet e KPT-së<sup>23</sup> dhe me aktet ndërkombëtare, siç janë: Rregullat e Mandelës<sup>24</sup> dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.<sup>25</sup>

### **Incidentet ndërmjet të burgosurve**

37. Për dallim nga situata e konstatuar në Raportin me rekomandime, i publikuar në vitin 2016, MKPT-ja vërejt se incidentet ndërmjet të burgosurve tani janë simbolike.

### **Personeli i Qendrës Korrektuese për Femra dhe të Mitur**

38. Personeli i Qendrës Korrektuese për Femra dhe të Mitur përbëhet prej 135 personave - personel i uniformuar, dhe 25 persona - personel civil. Prej këtij numri, 46 janë të gjinisë femërore. Po ashtu, qendra ka të angazhuar edhe 2 punëtorë socialë.
39. Gjatë vizitës, MKPT-ja mori ankesa nga personeli korrektues lidhur me numrin e vogël të zyrtarëve korrektues. Të njëjtin shqetësim e shprehu edhe Drejtoria e QKFM-së. MKPT-ja mori ankesa të shumta edhe për mosfurnizim me uniforma dhe me pajisje tjera, të domosdoshme për ta kryer punën e tyre.
40. Po ashtu, një nga ankesat e shpeshta, të cilat i pranon MKPT-ja nga zyrtarët korrektues, është edhe çështja e llogaritjes së stazhit të beneficuar. MKPT-ja vëren se neni 221 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale shprehimisht përcakton: *“Zyrtarët korrektues, për shkak të rrezikshmërisë, rëndësisë, si dhe kushteve të veçanta të punës, për çdo dymbëdhjetë (12) muaj pune i llogaritet si gjashtëmbëdhjetë (16) muaj stazh i siguruar, kurse në llogaritjen e pagave sigurohet një shtesë e të ardhurave.”*

<sup>21</sup> Praktika Standarde e Veprimit, pika 11. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>.

<sup>22</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 49.

<sup>23</sup> Standardet e KPT-së, publikuar në vitin 2018, paragrafët 50 dhe 51. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806ce943>.

<sup>24</sup> Rregullat e Mandelës, Rregulli 26, pika 2, në: [https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E\\_ebook.pdf](https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf).

<sup>25</sup> Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, pika A, Rregulli 19, në: [https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45\\_113.pdf](https://www.ohchr.org/Documents/ProfessionalInterest/res45_113.pdf).



41. Si edhe në raportet e mëparshme<sup>26</sup>, MKPT rithekson nevojën që të gjitha shqetësimet e personelit, autoritetet kompetentet duhet ti adresojnë me seriozitet.

### **Masat disiplinore**

42. Sipas legjislacionit në fuqi, dënimet disiplinore që mund t'u shqiptohen të dënuarve të mitur në QKFM janë: Qortimi, heqja e beneficionit të caktuar, urdhri për kompensim dhe veçimi.<sup>27</sup> Ndërsa në rastin e të paraburgosurve mund të shqiptohen dënimet si në vijim: Kufizimi apo ndalimi i vizitave apo korrespondencës, përveç kontakteve me avokatin mbrojtës, me Avokatin e Popullit dhe me misionet diplomatike.

43. Neni 122, paragrafi 1, i Kodit të Drejtësisë për të Mitur përcakton se dispozitat mbi procedurat disiplinore dhe dënimet e zbatueshme për personat e dënuar me burgim, të parapara në Ligjin mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, zbatohen përshtatshëm për të miturin, i cili i nënshtrohet masës së dërgimit në institucionin edukativo-korrektues. Me tej, më nenin 122, paragrafi 2, shprehimisht theksohet: *“Të miturit nuk i shqiptohet izolimi në qeli të veçantë si dënim disiplinor.”* Gjatë vizitës nga MKPT-ja, nuk pati të burgosur të ndëshkuar me masën disiplinore të izolimit.

44. MKPT-ja, gjatë vizitës, vërejti se i mituri L. L. ishte në veçim për arsye shëndetësore.

### **Kontakti me botën e jashtme**

45. Legjislacioni në fuqi<sup>28</sup> për rastin e personave të dënuar përcakton se të burgosurit e dënuar kanë të drejtë të pakufizuar të korrespondencës (që u nënshtrohen përjashtimeve të caktuara), kanë të drejtë për një vizitë në muaj, e cila zgjat më së paku një orë, si dhe një vizitë nga fëmijët dhe bashkëshortet e tyre, së paku një herë në 3 muaj, me kohëzgjatje minimale prej tri orësh.

46. Sa u përket të miturve, neni 120 i Kodit të Drejtësisë për të Mitur përcakton se i mituri ka të drejtë të vizitohet së paku një herë në javë, minimum deri në një orë, nga prindi i tij, prindi adoptues, kujdestari, bashkëshorti, fëmija, fëmija i adoptuar dhe nga të afërmit e tjerë të gjakut në vijë të drejtpërdrejtë ose në vijë anësore deri në shkallën e katërt. I mituri ka të drejtë të vizitohet së paku një herë në muaj nga persona të tjerë, të cilët nuk ndikojnë negativisht në ekzekutimin e masës.

47. Në rastin e të paraburgosurve, neni 200 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës përcakton se të paraburgosurit mund të pranojnë vizita *“brenda kufijve të rregullave të qendrës së paraburgimit”*, bazuar në lejen e gjyqtarit të procedurës paraprake dhe nën mbikëqyrjen e tij. Më tej, Kodi përcakton se korrespondenca dhe vizitat tjera i nënshtrohen vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake.

48. Sa u përket thirrjeve telefonike, neni 60 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton se i dënuari ka të drejtë të bëjë thirrje telefonike. MKPT-ja konsideron se kontaktet me botën e jashtme, veçanërisht vizitat nga familja apo nga të afërmit tjerë, janë të rëndësishë

<sup>26</sup> Shih Raportin me rekomandime për vizitën në Qendrën Korrektuese në Dubravë, në: <https://www.oik-rks.org/2018/08/30/raport-me-rekomandime-i-mekanizmit-kombetar-per-parandalimin-e-tortures-avokati-i-popullit-lidhur-me-viziten-ne-qendren-korrektuese-ne-dubrave/>.

<sup>27</sup> Paragrafët nga 101 deri në 113 të Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

<sup>28</sup> Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 62-65.

thelbësore në kontekstin e rehabilitimit social të të burgosurve. MKPT-ja nuk mori asnjë ankesë nga të burgosurit lidhur me këto të drejta.

### **Procedurat e pranimit**

49. Të gjithë të sapo pranuarit në QKFM në Lipjan i nënshtrohen procedurës së pranimit, e cila zgjat nga 7 deri e më së shumti deri në 28 ditë. Gjatë kësaj periudhe, i dënuari mbahet në pavijonin e pranimit dhe, pas kësaj periudhe, dërgohet në pavijonin adekuat, varësisht nga dënimi i shqiptuar apo masa edukative korrektuese.
50. MKPT-ja vërejt se QKFM-ja mban evidencë gjithëpërfshirëse për secilin të burgosur, ku regjistrohet në hollësi çdo detaj.

### **Procedura e parashtrimit të ankesave**

51. Standardet e KPT-së theksojnë rëndësinë e sistemit efektiv të parashtrimit të ankesave dhe e konsiderojnë atë si garanci themelore kundër keqtrajtimit në burgje dhe në qendra të paraburgimit.<sup>29</sup> Po ashtu, e drejta e të burgosurit për të parashtruar ankesë parashihet edhe me Rregullat e Mandelës<sup>30</sup> dhe me Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.<sup>31</sup>
52. Neni 91 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton në hollësi procedurën, sipas së cilës të paraburgosurit dhe të dënuarit mund t'i drejtohen me ankesë apo lutje drejtorit të një institucioni të caktuar të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Procedura përfshin edhe afatet për përgjigje nga drejtori dhe mundësinë që ankesa t'i drejtohet një autoriteti tjetër, që në rastin e tanishëm është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Korrektues dhe ministri i Drejtësisë.<sup>32</sup>
53. MKPT-ja vërejt se në dispozicion të të akomoduarve në QKFM në Lipjan gjenden kutitë e ankesave të vendosura nga Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) dhe nga DShB-ja. Kutitë e ankesave të vendosura nga IAP-ja mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesave. Po ashtu, të akomoduarit mund t'i drejtojnë ankesë Avokatit të Popullit edhe përmes linjës telefonike pa pagesë (informatat për linjën telefonike janë të vendosura në kutitë e ankesave), përmes postës së rregullt, e cila, sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nuk i nënshtrohet kontrollit nëse i adresohet Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, si dhe përmes familjarëve të tyre.
54. MKPT-ja vërejt se Drejtoria e QKFM-së në Lipjan ofron mundësinë adekuate për parashtrim të ankesave dhe të kërkesave, i shqyrton ato dhe u dërgon përgjigje të burgosurve në këtë qendër. Për më shumë, në dispozicion të të burgosurve është edhe kutia e ankesave e vendosur nga DShB-ja, ku ankuesit mund t'i paraqesin ankesat e tyre lidhur me ofrimin e

<sup>29</sup> Standardet e KPT-së, shih në: <https://rm.coe.int/16807bc668>.

<sup>30</sup> Rregullat e Mandelës, Rregulli 56.

<sup>31</sup> Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria, pika 75.

<sup>32</sup> Neni 91, paragrafi 4, i Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: Në ankimin e paraqitur drejtori i institucionit korrektues do të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në ankimin me shkrim do të jepet përgjigja në formën e shkruar.



shërbimeve mjekësore. MKPT-ja nuk mori ankesa nga të burgosurit sa i përket së drejtës për të parashtruar ankesë.

Në bazë të të gjeturave dhe konstatimeve të arritura gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 16, paragrafi 4, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i rekomandon:

**Ministrisë së Drejtësisë:**

- **Të përmirësohen kushtet e akomodimit në pavijonet ku mbahen të miturit e paraburgosur dhe në pavijonet tjera, kur një gjë e tillë është e nevojshme.**
- **Të zbatohet dispozita përkatëse e Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale sa i përket stazhit të beneficuar (shih paragrafin 40 të këtij Raporti).**

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht që të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

  
Hilmi Jashari

Avokat i Popullit